





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TE 7
Berat Buzhala
Drejtör
Prishtinë



VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2021/348- Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
TE 7 (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, me anë të të cilit përcaktohet sjellja e mediave gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë Udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje.
2. KPM, me qëllim që mediat të veprojnë në pajtim me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje, me datën 9 shtator 2021, dhe 1 nëntor 2021, për balotazh, përmes postës elektronike i ka dërguar ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale Ditarët A dhe B (për terminet e reklamave të emetuara pa pagesë dhe me pagesë) dhe po ashtu edhe sqarimin për plotësimin e tyre.
3. KPM-së bazuar në Raportin e monitorimit ka gjetur se Pala përgjegjëse ka dështuar t'i sjellë Ditarët javor A dhe B, duke vepruar kështu në kundërshtim me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, konkretisht me nenin 49, paragrafi 7.
4. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 25 nëntor 2021 i ka dërguar Njoftim për shkelje Palës përgjegjëse, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe ka kërkuar që në afat prej tre (3) ditësh t'i sjellin Ditarët A dhe B pas pranimit të Njoftimit.
5. KPM-së edhe pas kalimit të afatit nuk ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse lidhur me sjelljen e Ditarëve A dhe B.

Analiza ligjore

6. Përmes kësaj, Komisioni, konstaton se Pala përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 49, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet, i cili përcakton se:

"Nga transmetuesit kërkohet të mbajnë ditarë të veçantë ditorë, të siguruar nga KPM-ja për qasjet e siguruara pa pagesë dhe kohët për reklamim që i janë shitur çdo subjekti politik të certifikuar. Këta ditarë përgatiten dhe i dorëzohen KPM-së për çdo javë në përputhje me udhëzimet e dhëna. Pasi të merren, ditarët janë të hapur për t'u shikuar nga publiku."


7. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet, duke mos i sjellë Ditarët A dhe B.

Vendim

8. Pala përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumë prej 1,000 (njëmijë) euro në pajtim me nenin 30 paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së për shkelje të nenit 49, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

E drejta për ankesë

9. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
10. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Xhevat LATIFI
Kryetar



21.12.2021
Datë